




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-24-12784-1-2-1/C1020
14 Nr. 122/25
Dt. 05.03.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i ZPP-së** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) dhe
2. **Ari med L.L.C., Rr.Enver Maloku nr.22, Prishtine, emri i tregtar/ Ari med L.L.C., emri biznesit,** me seli në Prishtinë, me ARBK : 811997800, të cilën e përfaqëson z. **Jetmir Sherifi**, në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizim me Paisje Mjeksores - Ritender**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	12	78	4	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	7	7	1	2	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me Paisje Mjeksores -Ritender**, ashtu sikurse është specifikuar në **Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme pjesë e Dosjes së Tenderit.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: jo më gjatë se **30 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës.**

1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **QKMF-Vushtrri**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 29,980.00 €; [njëzetënmijëenqindëtetëdhjetë] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim- Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se Furnizim me Paisje Mjekësore - është dorëzuar – pranuar nga A.K. , si në aspektin teknik dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimin dhe / ose shërbimin e përfunduar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimit dhe / ose shërbimit është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit.

- Garancioni i kualiteti të mallit për Furnizimi me paisje mjekësore është 25 muaj nga data e dorëzimit paisjeve në vlerë **10% të kontratës (2,998.00€)**.
- Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues,



pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimit dhe / ose shërbimit të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e aktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.



14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.


3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:

Ari med L.L.C.

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e
Vushtrrisë

Emri:	Jetmir Sherifi	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Drejtör ekzekutiv	Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.03.2025	Data:	05.03.2025
Vula:		Vula:	



Numri i prokurimit: VU644-24-12784-1-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-24-077-121Titulli:

Blerja dhe furnizimi i pajisjeve mjekësore- Ritetender.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH , poashtu çmimin duhet ta shkrueni me dy decimale pas presëjes dhjetore

Në kolonën

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€	Shënim i operatorit ekonomik
1	Centrifuga Laboratorike për epruveta 16x100 me 28 vende (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	1	2966.10	18.00	3,500.00	2,966.10	533.90	3,500.00	
2	Fritz për ruajtjen e vaksinave (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	2	2966.10	18.00	3,500.00	5,932.20	1,067.80	7,000.00	
3	Fritz 290L-300L (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	1	2966.10	18.00	3,500.00	2,966.10	533.90	3,500.00	
4	Karige per marjen e gjakut (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	1	1388.89	8.00	1,500.00	1,388.89	111.11	1,500.00	
5	Njësitë per Destillimit të Ujit 4L (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	1	3644.07	18.00	4,300.00	3,644.07	655.93	4,300.00	
6	Termostatit për ajër të tharë (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	12	50.85	18.00	60.00	610.17	109.83	720.00	
7	Analyzer Immunologjik (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	1	5932.20	18.00	7,000.00	5,932.20	1,067.80	7,000.00	
8	Teste per Aparatin Immunologjik CRP (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	800	1.86	18.00	2.20	1,491.53	268.47	1,760.00	
9	Teste per Aparatin Immunologjik HbA1c (sipas specifikave të Aneksit nr 1 në Dosje)	Copë	200	2.97	18.00	3.50	593.22	106.78	700.00	
TOTALI PËRGJITHSHËM ME TVSH:							25,524.48	4,455.52	29,980.00	

Numri i prokurimit: VU644-24-12784-1-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-24-077-121 Titulli:

Blerja dhe furnizimi i pajisjeve mjekësore- Ritender

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ArMed L.L.C
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Jetmir Sherifi
NËNSHKRIMI:	
DATA:	13.12.2024
VULA:	